



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 541, datë 23.11.2021**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
    - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
    - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
  2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A. NJOHURITË LIGJORE

#### 1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e çështjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*...Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i zbaton ato në praktikë si dhe në tekstin e vendimeve përfundimtare. U konstatua se, në funksion të zbatimit të ligjit ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës Kushtetuese si dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në të gjitha çështjet penale të analizuar, është konstatuar se vendimi gjyqësor*

*përmban referenca ligjore, duke i kushtuar rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4) dhe arrin të analizojë shkaqet dhe rrethanat që çojnë në vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal (shih dosjen 5)....Natyra e çështjeve penale që ajo ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe tregon gjerësinë e njohurive të saj të përftuara përmes përvojës në punë. 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara tregojnë njohuri të tij lidhur me përgjegjësinë penale për veprat penale të “Vrasjes në rrethana të cilësuar”, parashikuar nga neni 79/dh i Kodit Penal (shih dokumentin 1), “Vjedhja e energjisë elektrike” parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal (shih dokumentin 2), “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal (shih dokumentin 3), “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal (shih dosjen 1), “Falsifikimi i dokumenteve” parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal (shih dosjet 2 e 3), “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal (shih dosjen 4) dhe për ankimet kundër vendimit të prokurorisë për mosfillim të procedimit penal (shih dosjen 5)”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

***- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik penal në vendimet burim vlerësimi vjen përgjithësisht i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, duke mos u mjaftuar vetëm me përshkrimin e faktit të parashtruar nga ana e organit të akuzës në kërkesën për gjykim. Thuhet përgjithësisht, pasi nuk konstatohet gjithmonë kjo shkallë kujdesi nga ana e gjyqtares në përshkrimin e faktit të integruar, pasi jo gjithmonë ky fakt vjen i plotë dhe i qartë.<sup>1</sup> Konkretisht, në vendimin nr. 1667, datë 15.05.2016, rrethanat e çështjes nuk janë të detajuara, ku citohen vetëm dy-tre prova shkresore, pa u përshkruar përmbajtja e tyre, nga të cilat fakti penal do të dilte më i qartë.<sup>2</sup>

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes, pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, vlen të theksohet se pavarësisht llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale apo kërkesë penale – mosfillim i procedimit penal*), rrethanat e fakteve parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, pas parashtrimit të rrethanave procedurale në lidhje me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore apo procedimin sipas ritit të gjykimit të shkurtuar në çështjet penale. Pavarësisht se nga ana e gjyqtares nuk rezulton që faktet të pasqyrohen në një nën-pjesë të titulluar në mënyrë eksplicite si “Rrethanat e faktit”, mënyra se si ato janë përshkruar në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve e bëjnë atë lehtësisht të dallueshme dhe të kuptueshme për lexuesin.

Kujdesi që gjyqtarja duhet të tregojë për paraqitjen, analizën, përcaktimin e ligjshmërisë së marrjes dhe përcaktimin e vlerës provuese të provave, si dhe analizën e tyre në mënyrë të

<sup>1</sup> Vendimi nr. 28, datë 14.01.2016 dhe vendimin nr. 1599, datë 18.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>2</sup> Në vendim gjykata arsyetohet se mungesa e dokumentacionit të kërkuar nga ligji provohet nga shkresat e dërguara nga institucionet përkatëse, pa cituar asnjë prej tyre.

integruar më njëra-tjetrën, për të mbështetur konkluzionet mbi faktin penal objekt shqyrtimi, nuk rezulton i dukshëm në çdo vendim burim vlerësimi. Në përgjithësi, në çështjet penale, në ato raste kur gjykimi i çështjes është zhvilluar sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, nuk rezulton që nga ana e gjyqtarës të bëhet një analizë e detajuar e provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre, në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij. Ndërkohë, një kujdes i tillë konstatohet tek 2 (dy) nga vendimet penale burim vlerësimi të përzgjedhura nga gjyqtarja.<sup>3</sup> Konkretisht, në vendimin e përzgjedhur penal nr. 2597, datë 05.11.2014 dhe vendimin nr. 1756, datë 27.05.2016, shihet një analizë e detajuar e veprimeve dhe mosveprimeve të të pandehurit në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, me qëllim përcaktimin apo jo të përgjegjësisë penale të të pandehurit për veprat penale të cilat i atribuohen.

Gjithashtu, gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*penal*), fakt që nuk i referohet vetëm asaj çfarë ka prezantuar organi i akuzës. Konkretisht, në vendimin penal nr. 1756, datë 27.05.2016, konform nenit 375 të K.Pr.Penale, në përfundim të gjykimit, gjykata i jep faktit penal një cilësim juridik tjetër nga ai i konkluduar nga ana e organit të akuzës.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës çështja i është paraqitur gjykatës për shqyrtim, ku në rastin konkret, të gjitha vendimet burim vlerësimi i përkasin natyrës juridike të çështjeve penale. Gjithashtu, gjyqtarja, pas përcaktimit të natyrës së çështjes, përcakton drejt llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, apo institutin procedural të kundërshtimit të vendimeve të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.

Përcaktimit të saktë të natyrës së çështjes i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj dhe këtë e pasqyron pothuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi, në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese, duke analizuar shkurtimisht juridiksionin dhe kompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes del qartë, edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm material dhe procedural***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke qenë se burim vlerësimi janë vetëm vendimet që i përkasin kategorisë së çështjeve penale (*themeli apo kërkesë penale*),

---

<sup>3</sup> Vendimi nr. 1756 date 27.05.2016 dhe vendimi nr. 2597 date 05.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

konstatohet se gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- a) Konkretisht, identifikon nenin 278 të K.Penal në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal nga “Prodhimit dhe mbajtjes së armëve luftarake” (*neni 278§5 i K.Penal*) dhe atë të veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes së armëve luftarake” (*neni 278§3 i K.Penal*),<sup>4</sup> nenin 137 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Vjedhjes së energjisë elektrike”,<sup>5</sup> nenin 291 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”,<sup>6</sup> nenin 186 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”,<sup>7</sup> nenin 236§2 të K.Penal në lidhje me çështjen penale për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik”,<sup>8</sup> nenin 199/a§1 të K.Penal në lidhje me akuzën e veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm”<sup>9</sup> dhe nenin 79§dh të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”.<sup>10</sup>
- b) Në çdo rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit apo edhe aplikimin e alternativave të dënimit (*nenet 47, 48, 49, 51 dhe nenet 59, 63 të K.Penal*), dhe dispozitat e dënimit me gjobë (*nenin 34 të K.Penal*).

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtarja ka referuar në çdo rast, si pjesë e integruar e arsyetimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal (*pothuajse në të gjitha vendimet ka cituar nenet 74 dhe 76 të K.Pr.Penale*)<sup>11</sup> në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës, procedurën e gjykimit të shkurtuar (*nenet 403 - 406 të K.Pr.Penale*), dispozitat ligjore lidhur me çmuarjen e provave dhe vlerën provuese të tyre (*nenin 152 e vijues te K.Pr.Penale*), nenin 375 për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit,<sup>12</sup>nenin 93 të K.Pr.Penale në lidhje me ndarjen e çështjeve,<sup>13</sup> dispozitat procedurale penale nenet 362 pika 1 dhe 3 të K.Pr.Penale në lidhje me kundërshtimin e dëshmisë së dhënë,<sup>14</sup> apo nenin 388 të K.Pr.Penale në rastin e deklarimit të pafajshëm të autorit, për shkak se nuk

---

<sup>4</sup> Vendimi nr. 1756, datë 27.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 2184, datë 17.06.2015, vendimi nr. 1599, datë 18.05.2016 dhe vendimi nr. 1946, datë 02.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 1755, datë 10.07.2014, vendimi nr. 374, datë 03.03.2014 dhe vendimi nr. 555, datë 20.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>7</sup> Vendimi nr. 28, datë 14.01.2016, vendimi nr. 1426, datë 30.04.2015 dhe vendimi nr. 437, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>8</sup> Vendimi nr. 1947, datë 02.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 1667, datë 15.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 2597, datë 05.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>11</sup> Mungon ky konstatim në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore në disa prej vendimeve penale, si në vendimin nr. 1947, datë 02.06.2015, në vendimin nr. 2184, datë 17.06.2015, në vendimin nr. 1599, datë 18.05.2016 dhe në vendimin nr. 1946, datë 02.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>12</sup> Vendimi nr. 1756, datë 27.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>13</sup> Vendimi nr. 1756, datë 27.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 2597, datë 05.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

provohet që vepra penale që i atribuohet të pandehurit të jetë kryer prej tij.<sup>15</sup> Në vendimin me objekt kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal,<sup>16</sup> gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës së ligjshmërisë së vendimit të organit të akuzës (*nenin 291 e vijues të K.Pr.Penale*).

*Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave*, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “Shumë të lartë” në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### 1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke i dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’u japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

<sup>15</sup> Vendimi nr. 2184, datë 17.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 161, datë 04.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i zbaton ato në praktikë si dhe në tekstin e vendimeve përfundimtare. U konstatua se, në funksion të zbatimit të ligjit ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuuese e Gjykatës Kushtetuese si dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në të gjitha çështjet penale të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke i kushtuar rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4) dhe arrin të analizojë shkaqet dhe rrethanat që çojnë në vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal (shih dosjen 5)....Natyra e çështjeve penale që ajo ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe tregon gjerësinë e njohurive të saj të përfutuara përmes përvojës në punë. 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara tregojnë njohuri të tij lidhur me përgjegjësinë penale për veprat penale të “Vrasjes në rrethana të cilësuar”, parashikuar nga neni 79/dh i Kodit Penal (shih dokumentin 1), “Vjedhja e energjisë elektrike” parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal (shih dokumentin 2), “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal (shih dokumentin 3), “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal (shih dosjen 1), “Falsifikimi i dokumenteve” parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal (shih dosjet 2 e 3), “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal (shih dosjen 4) dhe për ankimet kundër vendimit të prokurorisë për mosfillim të procedimit penal (shih dosjen 5).”*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt akuze dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pa shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen.

***- Në drejtim të interpretimit të ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së faktit penal, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të Kodit Penal, ndonëse jo në mënyrë abstrakte (*teorike dhe të pavarur nga fakti penal objekt shqyrtimi*), por gjithmonë duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete drejtpërdrejt mbi faktin dhe provat përkatëse objekt shqyrtimi. Gjyqtarja interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht, konstatohet se gjyqtarja aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, duke bërë zbërthimin e saj sipas elementëve të veprës penale, në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe

provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, e në vijim nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Gjithashtu, konstatohet, jo vetëm identifikimi, por edhe interpretimi i ligjeve të posaçme, në ato raste kur dispozita penale materiale ku referon fakti penal është një dispozitë blanket, si p.sh në vendimin nr. 1667, datë 15.05.2016, në të cilin gjykata interpreton dispozitat e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit” për të përcaktuar nëse i pandehuri në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me sa ka parashikuar ligji organik në lidhje me kryerjen e ndërtimeve që kanë nevojë për t’u pajisur paraprakisht me leje ndërtimi.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, evidentohet edhe interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*), ose aplikimin apo jo të alternativave të dënimit (*neni 59 dhe 63 të K.Penal*). Në këto raste, gjyqtarja ndalet kryesisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen, për të përfituar i pandehuri nga një masë dënimi më e ulët, apo dhënia e një dënimi alternativ, të parashikuar në nenin 59 apo 63 të K.Penal.<sup>17</sup> Gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë individualizimit të dënimit duke analizuar të gjitha rrethanat lehtësuese/rënduese që lidhen si me rrezikshmërinë e veprës penale, ashtu edhe me rrezikshmërinë e autorit në çdo rast, për të argumentuar pas kësaj analize të detajuar edhe konkluzionin në lidhje me caktimin e dënimit. Në të gjitha vendimet penale të themelit, për të mbështetur argumentimin mbi masën e dënimit, lidhur me llojin dhe masën e dënimit, gjyqtarja përcakton rrethanat që merren në konsideratë në caktimin e dënimit, duke i aplikuar ato mbi rastin konkret, në mbështetje të vlerësimit për përshtatshmërinë e masës së dënimit.

**- Në drejtim të interpretimit të ligjit procedural:**

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale penale, gjyqtarja i jep rëndësi më shumë zbatimit të normës, sesa interpretimit të saj. Gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi interpretimit të normës, në drejtim të zgjidhjes së situatave procedurale, të iniciuara nga palët (*kërkesat e palëve*), të iniciuara kryesisht, ose si domosdoshmëri e procesit të të provuarit. Konkretisht, konstatohet se gjyqtarja: (i) interpreton nenin 375 të K.Pr.Penale në lidhje me ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal me vendimin përfundimtar;<sup>18</sup> (ii) interpreton nenet 403 dhe 404 në lidhje me nenin 93/1/b të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, sa i përket plotësimit të kushteve ligjore të këtij neni, me pasojë pranimin e kërkesës,<sup>19</sup> etj. Kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, gjyqtarja interpreton drejtpërdrejt mbi faktin dispozitën procedurale për zgjidhjen e çështjes në themel (*neni 388 i K.Pr.Penale në vendimin nr. 2184, datë 17.06.2015, në të cilin gjykata ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit, pasi nuk provohet që e ka kryer ai veprën penale që i atribuohet, apo neni 290 i K.Pr.Penale në vendimin nr.1529/161, datë 04.05.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të cilin gjykata*

<sup>17</sup> Vendimi nr.1599, datë 18.05.2016, vendimi nr. 1946, datë 02.06.2015, vendimi nr. 1755, datë 10.07.2014, vendimi nr. 555, datë 20.03.2014, vendimi nr. 374, datë 03.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>18</sup> Vendimi nr. 1756 datë 27.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>19</sup> Vendimi nr. 1756 datë 27.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



ka vendosur pranimin e kërkesës për vazhdimin e hetimeve, pasi ato nuk kanë qenë të gjithanshme dhe në dilijencë të organit të akuzës).

**- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:**

Vlen të theksohet fakti se gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes gjyqtarja zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, çka evidentohet kryesisht duke u nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzioni i arritur. Gjyqtarja njih dhe zbaton parimet procedurale, siç janë: fuqia e plotë provuese, identifikohet dhe reflektohet përmbushja e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, gjyqtarja njih dhe zbaton parimet e së drejtës materiale, të cilat i shërbejnë dhe i vijnë në ndihmë interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në themel si: parimi i prezumimit të pafajësisë,<sup>20</sup> në çdo vendim penal zbaton drejtpërsëdrejti parimin e ligjshmërisë – *nullum crimen, nulla poena sine lege*, parimin e propocionalitetit të dënimit, etj.

**- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.**

Vetëm në 1 (një) vendim të analizuar, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, apo edhe vendime të Gjykatës Kushtetuese*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- *Gjykimin e shkurtuar*: Konstatohet se nga ana e gjykatës është cituar dhe zbatuar në pranimin ose jo të kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar vendimi unifikues nr. 2 datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.<sup>21</sup> Konstatohet se në vendimet e tjera penale burim vlerësimi edhe pse nuk është bërë në mënyrë specifike identifikimi i vendimit unifikues të sipërcituar, pranimi apo jo i kërkesës për gjykimin e shkurtuar është bërë duke u bazuar në konkluzionet e arritura të vendimit unifikues e në këtë kontekst, rezulton të jetë zbatuar drejtpërsëdrejti ky vendim në të gjitha vendimet burim vlerësimi.
- *Cilësimin juridik të veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”*: Gjykata mbështet konkluzionin e saj në cilësimin juridik të veprës penale e për rrjedhojë, në ndryshimin e cilësimin juridik të veprës penale, bazuar në nenin 375 të K.Pr.Penale edhe në zbatim të plotë dhe rigoroz të vendimit nr. 9/2016, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.<sup>22</sup>

## **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira të interpretimin të ligjit procedural dhe material penal, në shërbim të konkluzioneve të

<sup>20</sup> Vendimi nr. 2184 datë 17.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>21</sup> Vendimi nr. 1756 datë 27.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>22</sup> Vendimi nr. 1756 datë 27.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B. ARSYETIMI LIGJOR**

### **1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi i respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3, 4 e 5).*”

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Nuk konstatohet përdorimi në çdo rast i shkronjave “ç” dhe “ë” në vendimet e analizuara. Nuk rezulton të jenë përdorur terma teknikë, apo fjalë që krijojnë konfuzion lidhur me kuptimin dhe kontekstin e përdorimit të tyre. Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, gjyqtarja i referon ato në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të thjeshta, të ndërthurura me njëra tjetrën dhe të kuptueshme. Vendimet janë të organizuar përgjithësisht në paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe duke përdorur fjali hyrëse për paragrafë të caktuar, me qëllim orientimin e lexuesit për përmbajtjen e tyre.

#### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme e përdorur në arsyetim dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundëson lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi i respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3, 4 e 5).*”

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjorë nuk do

të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konkretisht, konstatohet se: Vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i shqyrtimit, akuza ndaj të pandehurit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.*

*Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilat në mënyrë të detajuar gjyqtarja analizon: (i) Rrethanat procedurale. Në këtë nënpjesë (edhe pse jo një nënpjesë e titulluar rrethanat procedurale ajo del nga analiza dhe parashtrimi i çështjeve dhe kërkesave me natyrë procedurale dhe jo të thelbit) gjyqtarja ka renditur çështjet e kompetencës dhe juridiksionit penal, për të vijuar më pas me kërkesat procedurale që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, si: pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar, ndarjes apo jo të çështjes, zhvillimit të gjykimit në mungesë të të pandehurit apo pranimi të kërkesës për të proceduar me avokat kryesisht, etj.; (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, përgjithësisht të integruara me provat (në prezantimin e fakteve përgjithësisht gjyqtarja bën një lidhje të provave me faktin penal të evidentuar), por edhe duke i listuar provat në ato raste kur procedohet me gjykim të shkurtuar. Në 2 (dy) vendime burim vlerësimi, kur është proceduar me gjykim të zakonshëm, provat jo vetëm citohen, por edhe analizohen, ndërkohë që mungon analiza e detajuar e provave në vendimet kur është proceduar me gjykim të shkurtuar; (iii) Ligjin e zbatueshëm (dispozitën e pjesës së posaçme të K.Penal në lidhje me akuzën që i atribuohet të pandehurit); (iv) Vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij, në përputhje me faktet konkrete, jo vetëm në lidhje me akuzën dhe përgjegjësinë penale të autorit, por njëkohësisht në një nën-ndarje të saj analizon në mënyrë të detajuar individualizimin e dënimit, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj.*

*Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me deklarin e pafajshëm të të pandehurit, apo dënimin e tij (sipas rastit), masën e dënimit të të pandehurit, aplikimin e gjykimit të shkurtuar, mënyrën e vuajtjes së dënimit, shpenzimet gjyqësore dhe hetimore, e drejta e ankimit, si dhe vendi dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në çështjet e kategorisë “Krimet”, vendimet përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383/ç të K.Pr.Penale, të ndryshuar*

## KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### 1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur Gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës së Lartë. Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetimin e tepërt, mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 6 prej tyre. Në të gjitha këto raste, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 2, 3 e 5). Në asnjë rast nuk është cenuar vendim për shkak të procesit të parregullt ligjor në aspektin

*e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se gjithmonë disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit për palët. Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi dhe gjithmonë kanë referuar edhe bazën ligjore”.*

**- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuar rezulton një nivel i mirë arsyetimi, përgjithësisht i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale.

Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore (*si p.sh në lidhje me ndryshimin e kualifikimit juridik të veprës penale, mbi gjykimin e shkurtuar, ndarjen e çështjes, individualizimin e dënimit, etj.*), në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në të gjitha vendimet gjyqësore, edhe pse jo në mënyrë të shprehur, ngritja e çështjes (*në lidhje me provimin e akuzës që i atribuohet të pandehurit*), vjen e nënkuptuar nga analiza dhe arritja e përfundimit ligjor. Po kështu, konstatohet identifikimi i tekstit normativ (*penal*) për t’u aplikuar, identifikimi i faktit se si teksti do të interpretohet, duke aplikuar faktet nga të dhënat në normë dhe pastaj konkluzionet.

Në pjesën më të madhe të vendimeve të analizuar (*kryesisht atyre të përzgjedhura me short*), konstatohet se gjyqtarja nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur pjesës së analizës së ligjit mbi provat. Ajo që konstatohet lehtësisht në mënyrën e të shkruarit të gjyqtarës është arritja e konkluzionit mbi zgjidhjen e çështjes duke u bazuar vetëm në faktin dhe pa bërë një analizë të provave, e në mënyrë të veçantë, pa bërë një analizë të mbështetur në prova të anës objektive të veprës penale.

Gjithashtu, konstatohet që edhe kur bëhet analiza e provave, ajo bëhet e shkëputur nga analiza juridike e elementëve të veprës penale, pa kaluar tek ligji i zbatueshëm relevant dhe analiza e këtyre elementëve të veprës penale. Konkretisht, në një prej vendimeve penale burim vlerësimi vendimi nr. 2184, datë 17.06.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet se vetëm në pjesën e përshkrimit të rrethanave të çështjes, nga ana e gjykatës është bërë analiza e provave, ndërkohë që ka edhe një paqartësi në këtë vendim, pasi në pjesën e ligjit të zbatueshëm (citimi i nenit 137 të K.Penal) nga mënyra se si janë përshkruar dhe analizuar elementët e kësaj figure të veprës penale, duket sikur arsyetimi dhe analiza e gjykatës shkon drejt përcaktimit të përgjegjësisë penale të tij për këtë vepër penale. Citimi tek objekti se: *“Veprimet e kundraligjshme të kryera nga ana e të pandehurit kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar përdorimin dhe administrimin e rregullt të energjisë elektrike si pronë shtetërore”*, apo tek ana objektive, duke u shprehur se: *“I pandehuri veprën penale e ka kryer me veprime aktive duke lidhur energjinë elektrike”*. Gjithë kjo analizë e bërë nga ana e

gjykatës nuk përputhet me konkluzionin e arritur dhe të analizuar në pjesën e përshkrimit të rrethanave të faktit në deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit.

Gjithashtu, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh: *Instituti të dënimit apo edhe të alternativave të dënimit* duke përcaktuar qëllimin, funksionin e tyre, si dhe kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për zbatimin e tyre, duke i analizuar në mënyrë të detajuar këto kritere në ligj, në përputhje me provat dhe rrethanat në çdo rast gjykimi.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së çështjes penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë lidhjes shkakësore (*të veprimeve dhe mosveprimeve të të pandehurit dhe ardhjes së pasojës së kundraligjshme*) dhe kur evidenton mungesë të saj konkludon në deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit.<sup>23</sup>

## KONKLUZIONE

Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, përmbush në përgjithësi standardet e procesit të rregullt ligjor, si dhe jep përgjigje të argumentuar për pretendimet e palëve, duke mbështetur konkluzionin e gjyqtares.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtares”

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

## 2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

<sup>23</sup> Vendimi nr. 2184 datë 17.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## 2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

### 2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga Gjyqtarja {...}, në 4 raste ka qënë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 1) deri në 3 muaj e 8 ditë (shih dosjen 4). Në dy dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 2 muaj e 14 ditë (shih dosjen 3) dhe 2 muaj e 16 ditë (shih dosjen 2)”*.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për asnjë prej tyre nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuarra më sipër, në të cilat nuk parashikohet ndonjë afat ligjor për përfundimin e tyre, aftësia e gjyqtares në lidhje me këtë tregues pikëzohet në nivelin maksimal të saj.



*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja vlerësohet “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Ankesa e vitit 2014 është verifikuar dhe regjistruar gjyqtares për zvarritje të gjykimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe çështjes të verifikuar dhe regjistruar gjyqtares për zvarritje gjykimi.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga Gjyqtarja {...}, në 4 raste ka qënë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 1) deri në 3 muaj e 8 ditë (shih dosjen 4). Në dy dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 2 muaj e 14 ditë (shih dosjen 3) dhe 2 muaj e 16 ditë (shih dosjen 2). Dosja e vetme me kohëzgjatje jashtë afateve standarde, është ajo për gjykimin e ankimit penal kundër vendimit të prokurorisë, në intervalin kohor 4 muaj e 23 ditë, tej afatit standard 2 mujor (shih dosjen 5). Vlen për t’u theksuar për këtë dosje, se në tre raste është vendosur nga gjykata shtyrja e seancës gjyqësore, për mosparaqitje të organit të prokurorisë. Në 4 nga 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton së kohëzgjatja e gjykimeve penale nga Gjyqtarja {...}, në të tre rastet ka qënë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 10 muaj e 5 ditë (shih dokumentin 1), 1 muaj e 18 ditë (shih dokumentin 2) dhe në 3 muaj e 16 ditë (shih dokumentin 3)”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur përgjithësisht brenda standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve rezultojn:

### Cështje penale:

- Dosja 1 - *(është caktuar me short në datën 16.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 03.03.2015)* Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 16 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 2 - *(është caktuar me short në datën 14.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 10.03.2014)* Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 25 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 3 - *(është caktuar me short në datën 16.02.2015 dhe ka përfunduar në datën 30.04.2015)* Gjykimi ka zgatur 2 muaj e 13 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 4 - *(është caktuar me short në datën 24.02.2015 dhe ka përfunduar në datën 02.06.2015)* Gjykimi ka zgatur 3 muaj e 6 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 6 - *(është caktuar me short në datën 28.05.2014 dhe ka përfunduar në datën 10.07.2014)* Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 12 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 7 - *(është caktuar me short në datën 05.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 20.03.2014)* Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 14 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 8 - *(është caktuar me short në datën 20.03.2015 dhe ka përfunduar në datën 15.05.2015)* Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 27 ditë, brenda afatit 4 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë kundravajtje);
- Dosja 9 - *(është caktuar me short në datën 12.03.2015 dhe ka përfunduar në datën 02.06.2015)* Gjykimi ka zgatur 2 muaj e 22 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 10 - *(është caktuar me short në datën 22.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 14.01.2016)* Gjykimi ka zgatur 3 muaj e 24 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 11 - *(është caktuar me short në datën 18.01.2016 dhe ka përfunduar në datën 18.05.2016)* Gjykimi ka zgatur 4 muaj e 3 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Vendimi 1 - *(është regjistruar në datën 30.12.2013 dhe ka përfunduar në datën 05.11.2014)* Gjykimi ka zgatur 10 muaj e 5 ditë, brenda afatit 12 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime-në minimum jo më pak se 10 vjet burgim);
- Vendimi 2 - *(është regjistruar në datën 29.04.2015 dhe ka përfunduar në datën 17.06.2015)* Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 18 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Vendimi 3 - *(është regjistruar në datën 11.02.2016 dhe ka përfunduar në datën 27.05.2016)* Gjykimi ka zgatur 3 muaj e 16 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);

### Kërkesa penale:

- Dosja 5 - *(është caktuar me short në datën 11.12.2015 dhe ka përfunduar në datën 04.05.2016)* Gjykimi ka zgatur 4 muaj e 23 ditë, tej afatit 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet e kërkesave administrative-penale.

## Çështje civile:

- Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 872-594, datë 08.10.2013, referuar relacionit të datës 12.12.2014, të Inspektoratit të KLD ku është trajtuar ankesa e paraqitur nga shtetasi B.Q., për zvarritje të gjykimit, rezulton se çështja i është caktuar me short gjyqtares {...} në datën 08.05.2012 dhe ka përfunduar në datën 08.10.2013. Gjykimi ka zgjatur 1 vit e 5 muaj, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga çështjet e analizuar për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, rezulton se 2 (dy) nga 15 (pesëmbëdhjetë) ose **13.33% e tyre** kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.

Përqindja matematikore prej 13.33% përkon me nivelin e vlerësimit 4 (katër) pikë, por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares. Pavarësisht se për 13.33% të çështjeve të shqyrtuara, rezulton tejkalimi i standardit minimal kohor të pranuar, rezulton se kjo nuk është pasojë e mosmenaxhimit efektiv të procesit, por pasojë e ecurisë procedurale të çështjes. Në relacionin të datës 12.12.2014 lidhur me analizimin e ecurisë së çështjes civile konkludohet se: *“Në çështjen civile objekt verifikimi, rezulton se mosmarrëveshja objekt gjykimi lidhet me pretendimin kryesor për zgjidhjen e pasojave juridike për pushimin e cenimit të pronësisë dhe dhënien e servitutit të kalimit.....Rezulton se gjatë gjykimit është marrë prova me ekspert, akt ekspertimit, ai shtesë, si dhe akti i ri i ekspertimit, të kryer gjatë gjykimit, të cilat kanë qenë dhe shkaqet kryesore të shtyrjes së seance gjyqësore”*.

Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 758 çështje, nga të cilat 601 çështje kanë qenë çështje penal themeli (krime dhe kundravajtje), mesatarisht 200 çështje themeli në vit.<sup>24</sup>

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar, që rezultojnë në masën 13.33%; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, të cilat, nga dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtares dhe (iii) standardi sasior i punës i cili është dukshëm më i lartë se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

---

<sup>24</sup> Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje).

**Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i standardeve minimale kohore” në kushtet kur përqindja e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal është 13.33%, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe procedurale që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

## **2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Ankesa e vitit 2014 është verifikuar dhe regjistruar gjyqtares për zvarritje të gjykimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga Gjyqtarja {...}, në 4 raste ka qënë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 muaj e 25 ditë (shih dosjen 1) deri në 3 muaj e 8 ditë (shih dosjen 4). Në dy dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 2 muaj e 14 ditë (shih dosjen 3) dhe 2 muaj e 16 ditë (shih dosjen 2). Dosja e vetme me kohëzgjatje jashtë afateve standarde, është ajo për gjykimin e ankimit penal kundër vendimit të prokurorisë, në intervalin kohor 4 muaj e 23 ditë, tej afatit standard 2 muaj (shih dosjen 5). Vlen për t’u theksuar për këtë dosje, se në tre raste është vendosur nga gjykata shtyrja e seancës gjyqësore, për mosparaqitje të organit të prokurorisë. Në 4 nga 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Përsa përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezultojnë se kohëzgjatja e gjykimeve penale nga Gjyqtarja {...}, në të tre rastet ka qënë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 10 muaj e 5 ditë (shih dokumentin 1), 1 muaj e 18 ditë (shih dokumentin 2) dhe në 3 muaj e 16 ditë (shih dokumentin 3)”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe çështjes civile të

verifikuar dhe regjistruar gjyqtarës për zvarritje gjykimi, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.<sup>25</sup>

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*nga 15 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 12 çështje penale themeli-krime, 1 çështje penale-kundravajtje, 1 kërkesë penale dhe 1 çështje civile themeli*), rezultoi se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 12 (dymbëdhjetë) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezultoi të jetë 3 muaj e 9 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale krime në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>26</sup>
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale kundravajtje”, rezultoi të jetë 1 muaj e 27 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale kundravajtje në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>27</sup>
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale”, rezultoi të jetë 4 muaj e 23 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve e kërkesave administrative-penale në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>28</sup>
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezultoi të jetë 1 vit e 5 muaj, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>29</sup>

## KONKLUZIONE

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon më një pikëzim prej 3 pikësh. Mbështetur në të njëjtin analizë si ajo e treguesit të mësipërm (*treguesi 2.A.b “Plotësimi i standardeve minimale kohore”*), gjyqtarja për këtë tregues pikëzohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, pasi gjyqtarja ka përballuar volum shumë të lartë çështjesh, duke tejkaluar standardin minimal kohor në masën 100%.

<sup>25</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

<sup>26</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

<sup>27</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

<sup>28</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “j. Gjykimet e çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtarë në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 2 muaj”.

<sup>29</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshme, jo më tej se 6 muaj”.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 4 pikë.

## **2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “*Subjekti rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke përcaktuar seksionin penal të kësaj gjykate, pra fushën e të drejtës penale. Ajo ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundi i janë caktuar gjithsej 1039 çështje, ka përfunduar gjithsej 823 çështje për tre vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 70 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 79.2%”.*

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} për periudhën 20.12.2013–08.10.2016, paraqet këtë ngarkesë çështjesh, të ndarë për çdo vit kalendarik:

Për vitin 2014 (01.01.2014-31.12.2014), gjyqtarës i janë caktuar për gjykim 354 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total për 291 çështje, nga të cilat 198 çështje penale, 1 çështje ushtarake, 84 kërkesa penale, 2 masa sigurimi dhe 6 kërkesa me të dëmtuar akuzues.

Për vitin 2015 (01.03.2015-31.12.2015), gjyqtarës i janë caktuar për gjykim 353 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total për 282 çështje, nga të cilat 217 çështje penale, 61 kërkesa penale dhe 4 kërkesa me të dëmtuar akuzues.

Për vitin 2016 (01.01.2016-08.10.2016), gjyqtarja ka përfunduar gjykimin në total për 185 çështje, nga të cilat 137 çështje penale, 1 çështje ushtarake, 42 kërkesa penale dhe 5 kërkesa me të dëmtuar akuzues.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti **79.2%** i përcaktuar në faqen 25 të Raportit.

## KONKLUZIONE

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi nuk bën vetëm një veprim matematikor për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai nivelit të përqindjes. Ky vlerësim mund të shkojë deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi. Në rastin konkret, rezulton se gjyqtarja {...} për periudhën e vlerësimit ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi: për vitin 2014 ka gjykuar 99% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (199 çështje të gjykuara, nga 100 çështje (krime dhe kundravajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës); për vitin 2015 ka gjykuar 117% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (217 çështje të gjykuara, nga 100 çështje (krime dhe kundravajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës); për vitin 2016 ka gjykuar 85% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (185 çështje të gjykuara, nga 100 çështje (krime dhe kundërvajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës). Në këto kushte gjyqtarja për këtë tregues gjyqtarja vlerësohet dy nivele më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” vlerësohet “Mbi 87-93%”, duke e pikëzuar me 6 pikë.*

## 2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se Gjyqtarja {...} i kushton shumë rëndësi arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve, pa patur vonesa dhe brenda afateve ligjore. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej saj pas 2 ditëve (shih dosjet 1 e 5), pas 3 ditëve (shih dosjet 2 e 4) dhe pas 5 ditëve (shih dosjen 3)”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit.

Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

**- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

- Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 374, datë 03.03.2014, është dorëzuar në datën 05.03.2014 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 437, datë 10.03.2014, është dorëzuar në datën 13.03.2014 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 1426, datë 30.04.2015, është dorëzuar në datën 05.05.2015 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 1947, datë 02.06.2015, është dorëzuar në datën 05.06.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 5, që i përket vendimit me nr.1529/161 akti, datë 04.05.2016 është dorëzuar në datën 06.05.2016 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 12.10.2021, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 1755, datë 10.07.2014 është dorëzuar në datën 14.07.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 555, datë 20.03.2014 është dorëzuar në datën 26.03.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;



- Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 1667, datë 05.05.2015 është dorëzuar në datën 20.05.2015 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 9, që i përket vendimit me nr. 1946, datë 02.06.2015 është dorëzuar në datën 05.06.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 28, datë 14.01.2016 është dorëzuar në datën 18.01.2016 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 1599, datë 18.05.2016 është dorëzuar në datën 20.05.2016 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

## KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## 2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

### 2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në pesë çështjet penale të vëzhguara, katër nga të cilat lidhen me vepra penale krime, kanë përfunduar me 3 e 4 seanca (shih dosjet 1, 2, 3 e 4) dhe çështja

*tjetër administrativo-penale, ankim kundër vendimit të prokurorit, është përfunduar me 7 seanca (shih dosjen 5). Rezulton se në të gjitha dosjet me çështje penale themeli, vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë brenda 10 ditëve, e parashikuar nga neni 333/1 i K.Pr.Penale dhe data për seancën e parë është caktuar për më tepër se 10 ditë, në përputhje të nenit 333/2 të K.Pr.Penale. Seancat e shtyra, në përgjithësi janë caktuar duke respektuar afatin maksimal 15 ditor, të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale, me përjashtim të dosjes 2 ku seanca e dytë gjyqësore e datës 18.02.2014 është caktuar 20 ditë pas seancës së parë dhe të dosjes 5, ku seanca e katërt e datës 29.03.2016, ishte caktuar rreth një muaj pas seancës së tretë. Konkretisht janë vëzhguar gjithsej 22 seanca gjyqësore, nga të cilat 14 kanë qenë produktive. Pengesë në 8 seancat joproduktive kanë qenë : Mosparaqitja e të pandehurit (1 seancë), caktimi i seancës gjyqësore në ditë feste zyrtare (1 seancë), mosparaqitja e prokurorit (3 seanca), mosformimi i trupit gjykues (2 seanca) dhe mosparaqitja e dëshmitarëve (1 seancë). Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek parashtrimet e palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare e gjer tek shpallja e vendimit”.*

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 (dhjetë) çështje vlerësohen si çështje me palë kundërshtare, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 – që i përket çështjes penale, me nr. 810 regjistri, datë regjistrimi 08.01.2014, gjykimin e të pandehurit për veprën penale të “Drejtimit i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr. 374, datë 03.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seanca ka rezultuar joproduktive, për mosparaqitjen e prokurorit dhe të pandehurit.
- Dosja 2 – që i përket çështjes penale, me nr.2539/700 regjistri, datë regjistrimi 30.12.2013, gjykimin e të pandehurit për veprën penale të “Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”, parashikuar nga neni 189/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.437, datë 10.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seanca ka rezultuar joproduktive, për mosparaqitjen e të pandehurit.
- Dosja 3 – që i përket çështjes penale, me nr.1606 regjistri, datë regjistrimi 13.02.2015, gjykimin e të pandehurit për veprën penale të “Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”, parashikuar nga neni 189/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.1426, datë 30.04.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, 2 (dy) nga të cilat kanë rezultuar joproduktive, për shkak të planifikimit në ditë pushimi zyrtar (Pashkët Ortodokse) dhe për mosformim të trupit gjykues (gjyqtarja nuk është paraqitur për arsye familjare).
- Dosja 4 – që i përket çështjes penale, me nr.1725 regjistri, datë regjistrimi 23.02.2015, gjykimin e të pandehurit për veprën penale të “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.1947, datë 02.06.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seanca ka rezultuar joproduktive, për mosparaqitjen e dëshmitarëve.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 – që i përket çështjes penale, me nr.2073 regjistri, datë regjistrimi 28.05.2014, gjykimin e të pandehurit për veprën penale “Drejtimit i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.1755, datë 10.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive.
- Dosja 7 – që i përket çështjes penale, me nr.1046 regjistri, datë regjistrimi 04.02.2014, gjykimin e të pandehurit për veprën penale “Drejtimit i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.555, datë 20.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive.
- Dosja 8 – që i përket çështjes penale, me nr.2108 regjistri, datë regjistrimi 19.03.2015, gjykimin e të pandehurit për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.1667, datë 15.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive.
- Dosja 9 – që i përket çështjes penale, me nr.1951 regjistri, datë regjistrimi 11.03.2015, gjykimin e të pandehurit për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.1946, datë 02.06.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seanca ka rezultuar joproductive, për mosformim të trupit gjykues. *(gjyqtarja nuk është paraqitur për shkak të pjesëmarrjes në një takim të organizuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me temë “Ndërtimi i shërbimit të specializuar për fëmijët viktime të abuzimit seksual”).*
- Dosja 10 – që i përket çështjes penale, me nr.4384/196 regjistri, datë regjistrimi 21.09.2015, gjykimin e të pandehurit për veprën penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”, parashikuar nga neni 189/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.28, datë 14.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, 1 (një) nga të cilat ka rezultuar joproductive, për mosformim të trupit gjykues. *(gjyqtarja nuk është paraqitur për shkak të pjesëmarrjes në shortin që do të zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për përzgjedhjen e dosjeve për efekt vlerësimi).*
- Dosja 11 – që i përket çështjes penale, me nr.1177 regjistri, datë regjistrimi 15.01.2016, gjykimin e të pandehurit për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr.1599, datë 18.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seanca ka rezultuar joproductive, për mosrealizimin e njoftimit për të pandehurin.

Nga tërësia e të dhënave siç parashtrihen më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli) varion nga 2, deri në 4 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3 seanca gjyqësore.

Bazuar në sa parashtrihet më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3

seanca dhe gjyqtarja në shumicën e rasteve ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit dhe numrit mesatar të seancave, i cili rezulton të jetë 3, vlerësohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve.... Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek parashtrimet e palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare e gjer tek shpallja e vendimit.... Për veprimet e kryera në seancë gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale penale (shih dosjet 1, 2, 3, 4 e 5)...Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, veprimet që janë kryer në seancë dhe dispozitivin e vendimit në fund të shqyrtimit gjyqësor. Por, konstatohet se 15 nga 22 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të padokumentuara me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Sa i përket fillimit me vonesë të seancës gjyqësore, rezultoi se nga 22 seanca të vëzhguara gjithsej, vetëm në 2 prej tyre është konstatuar vonesë mbi 15 minuta në çeljen e seancës gjyqësore, konkretisht me 17 e 37 minuta. Në rastin e vonesës më të madhe 37 minuta tek dosja 4, seanca gjyqësore e datës 02.06.2015, është dokumentuar si shkak “Pjesëmarrja e gjyqtarës si anëtare e trupit gjykues në një tjetër gjykim penal”.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 10 (dhjetë) prej tyre i përkasin kategorisë të çështjeve penale me palë kundërshtare dhe 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale në fazën e hetimit paraprak.

Gjyqtarja në çdo rast i ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, duke filluar nga 3 ditë, deri në 10 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara përgjithësisht janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur me shtypshkrim nga sekretarja gjyqësore, vetëm në disa raste seancat janë mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimi i mbrojtësit të caktuar kryesisht për të pandehurin, apo për të paraqitur konkluzionet përfundimtare me shkrim.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se në 20% të rasteve gjyqtarja ka planifikuar dhe zhvilluar seancat gjyqësore jashtë afatit procedural 15 ditor, të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.Penale, konkretisht: pas 34 ditësh;<sup>30</sup> pas 26 dhe 31 ditësh;<sup>31</sup> pas 20 ditësh;<sup>32</sup> pas 32 ditësh;<sup>33</sup> apo pas 39 ditësh.<sup>34</sup> Referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore nuk rezulton në asnjë rast që gjyqtarja të ketë pasqyruar faktin se përse seancat gjyqësore planifikoheshin jashtë këtij afati ligjor, si dhe nuk rezulton që shkak për mosrespektimin e këtij afati të jenë bërë pushimet vjetore në muajin gusht.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për të relatuar verifikimin e paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, relativimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm apo i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

---

<sup>30</sup> Shih dosjen nr. 9 – që i përket vendimit nr. 1946, datë 02.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>31</sup> Shih dosjen nr. 10 – që i përket vendimit nr. 28, datë 14.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>32</sup> Shih dosjen nr. 2 – që i përket vendimit nr. 437, datë 10.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>33</sup> Shih dosjen nr. 5 – që i përket vendimit nr. 161, datë 04.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>34</sup> Shih dosjen nr. 11 – që i përket vendimit nr. 1599, datë 18.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 7 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjyqimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjyqimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale penale (shih dosjet 1, 2, 3, 4 e 5). Në çdo dosje të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e përfaqësimit, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura.....Dosjet janë të inventarizuara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e më pas aktet procedurale të krijuara nga gjykata, duke pasqyruar kronologji në renditjen e akteve dhe duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet dhe shkresat e kryera gjatë gjykimit në rend kronologjik, provat shkresore të dorëzuara në seancë për shkak të paraqitjes së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

## **2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Dosjet janë të inventarizuara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e më pas aktet procedurale të krijuara nga gjykata, duke pasqyruar kronologji në renditjen e akteve dhe duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore),

si dhe aktet e paraqitura nga palët (*konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësitë organizative të gjyqtares”**

<b>KRITERI</b>	
<b>AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES</b>	
<b>Niveli i vlerësimit</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	95

## **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.*

### **3.A. ETIKA NË PUNË**

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për Gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.”.

#### **3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:



- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1310/3 Prot., datë 30.10.2020, rezulton se 1 (një) ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje të gjyqimit dhe i është evidentuar për efekt vlerësimi etik dhe profesional. Në lidhje me këtë ankesë rezulton se:

Shtetasi B.Q., ka bërë ankesë pranë KLD në vitin 2014 ndaj veprimtarisë së gjyqtares {...} për zvarritje të gjyqimit në lidhje me çështjen civile me paditës B.Q., të paditur Bashkia Laç dhe Gj.Q., me objekt “Anulim akti administrativ”, për verifikimin e së cilës është nxjerr urdhri nr. 2357/2 Prot., datë 24.09.2014.

Në datën 12.12.2014 inspektorët e KLD pasi kanë verifikuar ankesën dhe dokumentacionin përkatës kanë konkluduar se: *“Nga verifikimi i dosjes civile rezulton se nga data e paraqitjes së padisë 15.02.2012 deri në dhënien e vendimit në gjykatën e shkallës së parë 08.10.2013, ka zgjatur gjithsej 1 vit 7 muaj dhe 23 ditë, ndërsa nga data e caktimit të gjyqtares {...} ndaj së cilës është paraqitur ankesa dhe është subjekt verifikimi datë 08.05.2012 deri në dhënien e vendimit prej këtij të fundit datë 22.07.2013, ky gjykim ka zgjatur 1 vit e 5 muaj.... Sa më sipër, vlerësojmë se planifikimi i seancave gjyqësore për një afat kohor mbi 30 ditë, përbën zvarritje të gjyqimit të çështjes, ndërkohë që zvarritje të gjyqimit ka përbërë dhe pranimi i kërkesave për paraqitjen e provave gjatë gjyqimit, në një kohë që referuar nenit 158/a të K.Pr.Civile, provat përcaktohen vetëm në seancë përgatitore, me qëllim që palët të mos pengojnë ecurinë e mëtejshme të procesit gjyqësor. Rrjedhimisht seanca përgatitore nuk ka qenë efiçente. Ndërkohë që nga gjyqtarja janë lejuar shtyrje të seancave gjyqësore për mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse, që ka paraqitur dhe ankimin në KLD. Gjyqtarja nga ana e vet, me përjashtim të kohëzgjatjes së shtrirjes së seancave gjyqësore, të cilat në 3 nga 18 raste rezultojnë të jenë mbi 30 ditë, brenda mundësive të ngarkesës së punës së gjykatës së rrethit Gjyqësor Kurbin ka organizuar punën për zgjidhjen e saj brenda afatit kohor, por pavarësisht kësaj afati maksimal i gjyqimit për këtë lloj çështje është kapërcyer. Për rrjedhojë provohet shkelje e afateve të gjyqimit, por shkaqet e shtyrjes së seancave të cilat kanë çuar në zvarritje të gjyqimit, kanë qenë të justifikuara, dhe bazuar në nenin 34/2 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, çmujmë se shkeljet e konstatuara gjyqtares {...} t’i evidentohen për efekt vlerësimi profesional dhe etik të saj.”*

Gjithashtu, rezulton se për periudhën e vlerësimit, ndaj gjyqtares {...} është paraqitur ankesa e shtetasit B.H., depozituar në KLD me nr. 805/1 Prot., datë 06.06.2013, regjistruar në Zyrën e ILD me nr. 2755 Prot., datë 17.11.2020. Ankesa është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe zvarritje të gjyqimit dhe është i është evidentuar gjyqtares për efekt vlerësimi etik dhe profesional.

Lidhur me këtë ankesë, ILD me vendimin nr. 2446/1 Prot., datë 09.06.2021, ka vendosur: *“Arkivimin pas verifikimit të ankesës së shtetasit z.B.H. regjistruar në ILD me nr. 2755 Prot., datë 17.11.2020. Praktika mbi rezultate e ankesës për gjyqtaren znj. {...}, t’i përcillet organit kompetent KLGJ, sipas konkluzioneve të verifikimit të KLD-së, për t’u mbajtur në konsideratë për efekt vlerësimi etik-profesional të saj”.*

Në vendimin e ILD, lidhur me pretendimet e ankuesit B.H, ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës {...} analizohet se: *“Me urdhrin nr. 805/2 Prot., datë 22.10.2013 të kryeinspektores së ish-KLD, është urdhëruar verifikimi i ankesës së shtetasit B.H., ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, {...} për mosrespektim formal të ligjit dhe zvarritje gjykimi”. Në përfundim të verifikimit, inspektorët përgjegjës në Relacionin e tyre të miratuar nga eprorët në rang hierarkie të KPK-së, kanë konkluduar: - afati i gjykimit të çështjes civile të ankuesit nga ana e gjyqtarës {...} është në respektim të afateve të parashikuar në vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2020 “ Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”; - në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës në gjykimin e kësaj çështje vërtetohen fakte dhe rrethana që kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit, prandaj është sugjeruar t’i bëhet pjesë e dosjes së vlerësimit profesional dhe etik të saj”*

Referuar akteve të dosjes së rivlerësimit, si dhe dosjes personale të gjyqtarës {...}, nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të jetë dhënë apo zbatuar masë disiplinore ndaj saj.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që të dëshmojnë shfaqje e sjellje që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 389, datë 20.05.2021, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarës, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional dhe nuk janë evidentuar problematika.

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”*.

### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;  
Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, në periudhën e vlerësimit, të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur dy (dy) ankesa në Inspektoratin e ish KLD. Ankesat janë paraqitur në vitin 2014 dhe janë referuar dhe analizuar në treguesin e analizuar më sipër. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: *“Në konkluzion për rivlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre dhe se konkludimi i arritur, në pikën 2.6 dhe 4.17 të këtij vendimi, proporcionalisht dhe objektivisht në tërësi të vlerësimit të këtij kriteri, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë mase disiplinore sipas parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ndaj subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016”*.<sup>35</sup>

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 389, datë 20.05.2021, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në

---

<sup>35</sup> Faqe 29 e vendimit të KPK nr. 389, datë 20.05.2021.

lidhje me integritetin e gjyqtares, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: *“Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit {...} arrin nivel të besueshëm, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar”*.<sup>36</sup>

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

*Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

### **3.C PAANËSIA E GJYQTARES**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme”*.

#### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

<sup>36</sup> Faqe 29-30 e vendimit.

- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarës.

### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Në 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.....”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarës, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit. Duke iu

referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

#### **4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

***Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.***

##### **4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se Gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e saj. Në të gjitha rastet e vëzhguara, nuk është konstatuar që palët të kenë paraqitur kërkesë për përjashtim të gjyqtares, ndërsa nuk u konstatuan raste dhe as kërkesa të vetë gjyqtares për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes”.

#### **4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

#### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 6 nga 8 rastet, subjekti i rivlerësimit ka qënë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën gjyqësore sipas rregullave procedurale penale”.

#### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;



- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësisë profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe

mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...}, për shkak të funksionit të gjyqtarës të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 11 trajnime, gjithsej 19 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarës të shkallës së parë, në përbërje të dhomës penale. Subjekti i rivlerësimit {...} ka deklaruar se ka marrë pjesë edhe në një aktivitet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, me temë : “Etika gjyqësore”, në Tiranë, më 11 prill 2014”.

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1310/3 Prot., datë 30.10.2020, vërtetimit me nr. 672/1 Prot., datë 27.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.672/1 Prot., datë 27.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 11 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 19 ditë trajnimi.

Gjithashtu, gjyqtarja ka marrë pjesë në 1 (një) aktivitet trajnues, jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, konkretisht, në trajnimin “Etika gjyqësore”, e organizuar nga OPDAT (*Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training*), në Tiranë, 11 prill 2014.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 12 aktivitete të zhvilluara për 20 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë, në gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësisë profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarës në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Referuar shkresës me nr. 373 Prot., datë 28.09.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe shkresës nr. 16291 Prot., datë 06.11.2016 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të paraqitura nga gjyqtarja në mbështetje të kundërshtimeve të saj, rezulton se gjyqtarja {...} ka udhëhequr kandidatë për magistratë për kryerjen e praktikës paraprofesionale, për periudhën 03 tetor – 9 dhjetor 2016.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se ka të dhëna, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

*Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit, etj.

Referuar akteve të depozituara nga gjyqtarja, konkretisht, vendimit nr. 47, datë 14.12.2015 të Mbledhjes së Përgjithshme të Konferencës Gjyqësore Kombëtare, rezulton se gjyqtarja {...} është caktuar anëtare e Komisionit të Etikës, Verifikimit të Mandateve dhe Përmirësimit të Vazhdueshëm Profesional.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë për këtë tregues.

***Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.*

***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”***

KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	95

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE  
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	95	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	390	Shkëlqyeshëm

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**